

VENDIM
Nr.115, datë 25.2.2005

PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT SHTETËROR TË SIGURISË PORTUALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 36 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale, në varësi të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, brenda strukturës së Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
2. Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale shqyrton planet e sigurisë së porteve dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Autoriteti ka si objekte kryesore të veprimtarisë së tij:
 - a) Shqyrtimin dhe përgatitjen për miratim të një plani sigurie për operatorët, të cilët veprojnë në transportin detar;
 - b) Përcaktimin e kërkesave për një deklaratë sigurie;
 - c) Caktimin e nivelit të sigurisë, që do të zbatohet në infrastrukturën portuale dhe në anije;
 - ç) Kontrollin e zbatimit të planit të sigurisë dhe të operatorëve, që veprojnë në transportin detar.
4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano